





# Familja e B. Vokshi nga Gjilani, operacioni në zemër që i ktheu qetësinë e munguar prej 6 vitesh!





**Dr. Karantonis mjeku specialist ne Kirurgjinë Plastike vjen në Kosove më datën 22, 23 dhe 24 Korrik**

26/01/2018

Pas disa ekzaminimeve të kryera në mjekë të ndryshëm, B.V u diagnostikua me stenozë e rëndë e valvulës aortale, Aorta ascendente e kalcifikuar ( porcelan aorta ). Zgjidhja e vetme për të ishte vetëm operacioni në zemër.

Nga momenti i diagnostikimit dhe rrezikut permament për jetën e pacientes, familjarët e Bikas kanë trokitur në spitale të ndryshme për të gjetur trajtimin adekuat.

Të shqetësuar, fillimisht janë drejtuar në QKUK. Duke parë që në klinikë nuk mund të marrin shërbim janë drejtuar në QSUT në Tiranë. Për disa kohë pacietja është mbajtur me shpresën se aty do të operohet dhe në momentin final është refuzuar nga mjekët.

Të zhgënjyer nga refuzimi për operacion i janë drejtuar dy spitaleve private me emër në Shkup me shpresën se aty do të gjejnë shërim.



Mirëpo edhe në dy spitalet private të Shkupit pas disa kontrollesh pacientes i komunikohet e njëjta gjë, nuk mund të operohet!

Të zhgënjyer dhe pa shpresë kthehen në Gjilan. Pacientja në datën 14 Dhjetor 2017 paraqitet në Spitalin Amerikan në Prishtinë, hospitalizohet dhe mbahet në monitorim.

Ekipi i mjekëve kardiokirug Dr.Besnik Kojcici dhe Dr.Fatos Kojqiqi pasi kanë vlerësuar në tërësi gjendjen e pacientes, së bashku me ekipin e mjekëve anestezist, Dr.Ismet Jusufi dhe Dr.Feim Mucolli, kanë vendosur për mënyrën e operacionit. Dr.Besnik Kojqiqi-Shef i Kardiokirurgjisë në Spitalin Amerikan:

– Është realizuar me sukses ndërrimi i valvulës aortale, rrezikshmëria për këtë operacion ka qenë e madhe për shkak të kalcifikimeve të mëdha në murret e aortës.

Risku i pësimit të ndonjë infarkti në tru është i lartë tek këta pacientë për shkak të procedurës se klampimit ( mbylljes ) së aortës, procedurë kjo e realizuar në një mënyrë të veçantë. Operacioni zgjati 4 orë dhe pacientja ditën 7-të del nga spitali


**Dr. Fotios Filippos Karantonis mjeku specialist ne Kirurgjinë Plastike dhe Rikonstruktive, vjen në Kosove me 10, 11, 12 Qershor**

**Pas zbulimit të kësaj metode shumë pacientë nuk do të kenë nevojë për operacionin në zemër të hapur**

**Dr. Karantonis, specialist në Kirurgjine Plastike dhe Rikonstruktive vjen më 5 mars në Kosovë**

**Pas disa vitesh vuajtje, qytetari nga Maqedonia kërkon shërim në Spitalin Amerikan**

**1.5 mln njerëz pa ujë të pijshëm, shqiptari tregon tmerrin që solli uragani në Porto Rico**

**Shkon në gjendje të rëndë në spital, ja çfarë i bëjnë mjekët pacientit nga Fushë Kosova!**

**6 simptoma të infarktit në zemër tek gratë**

mënyrë të veçantë. Operacioni zgjati 4 orë dhe pacientja ditën 7-të doli nga spitali.

Djali i pacientes Lirim Vokshi, i pyetur se ku është informuar për Spitalin Amerikan, shprehet:

– Për Spitalin Amerikan nuk kam dëgjuar nga askush por i kam besuar në punë sepse edhe gruaja më ka lind aty, ndërsa për vëllezërit Kojqiqi po fliste gjithë Kosova mirë. Unë nuk i kam njohur kurrë derisa kam ardhur në Spitalin Amerikan. Për ta kam dëgjuar në mjekë të ndryshëm dhe më kanë thënë se nëse operacionin nuk e kryejnë vëllezërit Kojqiqi, këtë operacion smundet ta kryejë askush.

Së fundmi Lirimi e mbyll bisedën me një urim të veçantë:

– Ne familja Vokshi përshëndesim dhe falenderojmë Spitalin Amerikan dhe në vecanti Dr.Besnikun, Dr.Fatosin, Dr.Arbenin, Dr.Ismetin dhe gjithë stafin e kardiokirurgjisë për kontributin e dhënë ndaj nënës sonë Znj Bika Vokshi. Fal zotit dhe profesionalizmit të stafit të Spitalit Amerikan ajo sot jeton dhe pa asnjë problem.



Tweet






## Te fundit nga kategoria

**Ekskluzive / Tahiri thotë se Ramushi është njëfarë “gjyksi”**

Pozita 9 / Dynden refugjatët, Bosnja paralajmëron BE’në



**Ekskluzive / Ndërtesa që shkëlqen në Arbëri, Albdizajn Residence**

Pozita 9 / Allegri e Juventusi, shpresat te Cristiano Ronaldo

**Ekskluzive / Rusia shitësja më e madhe e armëve**

Pozita 9 / Allegri e konfirmon mungesën e madhe për Atleticon dhe zbulon dy startues jo shumë të njohur!



**Ekskluzive / Linda Halimi bëhet nënë për herë të parë**

Pozita 9 / Rita, vjen me fotografi të veçanta

Express

Ky website kontrollohet dhe menaxhohet nga Media Works. Të gjitha materialet , përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me të drejta autoriale të Media Works. Materialet janë për shfrytëzimin personal tuajin dhe për qëllime jo-komerciale. Ato nuk mund të kopjohen, riprodhohen, ripublikohen, modifikohen, transmetohen, ose distribuohen në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të Gazetës Express. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë website ose medium tjetër, pa lejen e Gazetës Express, është shkelje e drejtave autoriale dhe është i ndaluar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Partner Medial

Shkabaj